



Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received/Delivery	20	10	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org.Junit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
SKAMBHCK	6353/2022		1/3		



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.772/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.772/2022 të datës 06.09.2022, të parashtruar nga ankuesja Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimi/Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar me ankesën me numër A.nr.772/2022 të datës 06.09.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Podujevës sipas Akt Emërimit të datës 01.09.2021, në pozitën "Zyrtare për Kadastër dhe Gjeodezi 4-KG-80", në Drejtorinë e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, me datë 21.04.2022 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Divizionit të Personelit në Komunë të Podujevës, për kompensimin e një (1) page mesatare në shërbimin civil në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes përkatësisht me rastin e vdekjes së vëllaut i cila ka vdekur me datë 31.03.2022 të dëshmuar sipas Certifikatës së vdekjes të lëshuar nga Komuna e Podujevës me datë 21.04.2022.

Me datë 23.05.2022 Kryetari i Komunës së Podujevës ka nxjerrë Vendim me numër 02-120/10-0036470/22 me të cilin ankueses i është lejuar kompensimi i një (1) page mesatare gjegjësisht mjetet monetare në vlerën e pagës mesatare prej 389.20 euro, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes së nëpunësve civile në bazë të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Paga dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil.

Ankuesja e pakënaqur me mosekzekutimin e pagesës më datë 02.09.2022 përmes postes së Kosovës, ka parashtruar ankesë me numër protokolli: 5171/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin



Civil të Kosovës, e cila është pranuar me datë 06.09.2022 ne Këshillë. Ankuesja përmes ankesës pretendon që Zyra e Personelit në Komunë të Podujevës të marr vendim për kompensimin e një page shtesë me rastin e vdekjes së vëllaut të saj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Paga dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunë të Podujevës, ndërsa më datë 21.09.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës dhe provat shtesë përmes e-mailit zyrtar me date 18.10.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit: 5171/2022 të datës 06.09.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Postes së Kosovës e vulosur me datë 02.09.2022; Vendimi me numër 02-120/10-0036470/22 i datë 23.05.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës; Deklarata e noterizuar e datës 07.07.2022 nga Noteri _____ prej ½ faqe me numër LRP:Nr.7099/2022; Certifikata e vdekjes e datës 21.04.2022; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civil e datës 04.07.2022; Letërnjoftimi; Kopje e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Paga dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil; Pliko postare e datës 02.09.2022 nga Posta e Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 19.09.2022; Akt emërimi i datës 01.09.2021; Formular për kërkesë dhe ankesë e datës 21.04.2022 e bashkangjitur dhe kërkesa e veçantë e datës 21.04.2022 drejtuar Zyrës së Personelit; Pliko/zarf e datës 21.09.2022 përmes Postes së Kosovës me numër R2484034; E-mail i datës 18.10.2022 kërkesë e KPMSHCK për provë shtesë drejtuar Zyrës së Personelit; E-mail i datës 18.10.2022 përgjigje nga NBNJ në kërkesë të KPMSHCK-së, me provat e bashkangjitura; Formularin e te dhënave për listën e pagave e datës 09.08.2022 përkatësisht Kërkesë për pagese retroaktive.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është ***bërë i pamundur, sepse:***

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesja me datës 06.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5171/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos realizimin e kompensimit të një page shtesë me rastin e vdekjes së vëllaut të saj, gjegjësisht ajo pretendon që pretendon që Zyra e Personelit në Komunë të Podujevës të marr vendim për kompensimin e një page shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes së nëpunësit civil ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Paga dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil përkatësisht nenit 22 paragrafin 2.

Komunës së Podujevës, përmes Zyrës për Burime Njerëzore, më datë 18.10.2022 përmes e-mailit zyrtar ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se me datë 23.05.2022 Kryetari i Komunës së Podujevës ka nxjerrë Vendim me numër 02-120/10-0036470/22 me të cilin ankueses i është lejuar kompensimi i një (1) page mesatare gjegjësisht mjetet monetare në vlerën e pagës mesatare prej 389.20 euro, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes së nëpunëses civile sipas Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Paga dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil si dhe ka bashkangjitur si dëshmi formularin e te dhënave për listën e pagave të datës 09.08.2022 përkatësisht kërkesën për pagese retroaktive, ku dëshmohet se është dërguar ne divizionin e pagesave, kërkesa e aprovuar nga nëpunësi i autorizuar i Komunës së Podujevës për pagese retroaktive në vlerë 389.20 euro për kompensimin e pagës shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes-vëllait të ankueses Naime Ademi me date 09.08.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 02-120/10-0036470/22 të datë 23.05.2022, të Kryetarit të Komunës së Podujevës me të cilin ankueses i është njohur e drejta e ndihmës institucionale gjegjësisht kompensimi i një (1) page mesatare në vlerën e pagës mesatare prej 389.20 euro me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes-vëllait në bazë të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Paga dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil si dhe aprovimit të pagesës retroaktive të pagës shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes-vëllaut në vlerë prej 389.20 euro për ankuesen nga Komuna e Podujevës, i cili ka qenë edhe pretendim i ankueses, atëherë Kolegji konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur apo i kotë sepse me këtë rast pretendimi i ankueses është përmbushur apo realizuar, dhe mbi këtë bazë nuk ka me objekt shqyrtimi gjegjësisht objekti i lëndës është bërë i pamundur, ashtu siç përcaktohet me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 i cili thekson se: **“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”**, andaj me rastin konkret Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar kushtet për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën e datës 06.09.2022 të parashtruar nga ankuesja

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.772/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse



Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunë të Podujevës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.